FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri:202

Tiranë – E mërkurë, 25 nëntor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Shëndetësisë nr. 2, datë 5.1.2015	Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit datë 2.8.2013 "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".....	13207
Udhëzim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 255, datë 3.11.2015	Për përcaktimin e kushteve dhe tarifave për marrëveshjet e krijimit të servitutit në punimet minerare nëntokësore horizontale.....	13211
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 17.11.2015	Me objekt interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.....	13213
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 67, datë 17.11.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 956 akti, datë 20.10.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 437, datë 20.4.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-106, datë 23.1.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	13214
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 68, datë 17.11.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1841, datë 20.9.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si edhe nr. 00-2014-4075, datë 30.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dhoma e këshillimit.....	13222
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 69, datë 17.11.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-4241 (619), datë 20.11.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	13225
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 70, datë 17.11.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014 dhe nr. 00-2014-1772 (188), datë 1.10.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	13232

Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4865/4, datë 13.11.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës nga Muzeu Historik - Spitali, Vlorë".....	13240
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 1411/6, datë 13.11.2015	Për shpronësim, për shkak të rikonstruksionit, të bulevardit "Jakov Xoxa", në Bashkinë e Fierit.....	13241
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5275/4, datë 16.11.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të "Rrjetit të Kanalizimeve të Vlorës, faza 2, IPA 2012".....	13242
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 5465/3, datë 16.11.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës nr. 5, loti 2 dhe 3, Sarandë".....	13243

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 2, datë 5.1.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, DATË 2.8.2013, "PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË TË TË GJITHË FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet katër ministrive, datë 2.8.2013, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor",

URDHËROJMË:

1. Miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, datë 2.8.2013, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, të gjitha institucionet dhe strukturat e përcaktuara në rregullore.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

RREGULLORE
PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË TË TË GJITHË FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet katër ministrive, datë 2.8.2013, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor",

URDHËROJMË:

1. Lista e fëmijëve, që duhet të ndjekin klasën e parë, përmban këta përbërës:

Emri, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, numri personal, gjinia, datëlindja, vendlindja dhe vendbanimi.

2. Strukturat vartëse të MAS-it, brenda datës 1 mars, të dërgojnë, në format elektronik, datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor te Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe te njësitë arsimore vendore dhe këto të fundit, brenda datës 5 mars, të dërgojnë me shkresë zyrtare, te qendrat përkatëse shëndetësore datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor.

3. Qendrat shëndetësore, brenda datës 2 prill, të dërgojnë në format elektronik ose me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë, përkatësisht te drejtoria përkatëse rajonale e shëndetësisë/drejtoria përkatëse e shëndetit publik/autoriteti shëndetësor rajonal i Tiranës.

Përbërësit për fëmijët janë parashtruar në pikën 1.

(Fëmijët, që kanë detyrimin të regjistrohen në klasën e parë, janë ata sipas përcaktimit të bërë në ligjin për arsimin parauniversitar.)

4. MPB-ja, brenda datës 10 prill, të dërgojë në MAS, në format elektronik, listën e fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor sipas përbërësve të parashikuar në pikën 1.

5. Drejtoria përkatëse Rajonale e Shëndetësisë/ Drejtoria e Shëndetit Publik/Autoriteti Shëndetësor Rajonal i Tiranës, brenda datës 10 prill, të hartojnë në format elektronik listën përmbledhëse të të dhënave të paraqitura nga qendrat shëndetësore dhe t'ia dërgojnë Ministrisë së Shëndetësisë (MSH).

6. Çdo njësi arsimore vendore, brenda datës 10 prill, me qëllim evidentimin e familjeve të fëmijëve që janë në rrezik të mos ndjekin klasën e parë:

a) të bashkëpunojnë me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal;

b) të bashkëpunojë me të gjitha shkollat dhe grupet e tjera të interesit.

7. MSH-ja të dërgojë te MAS-i, brenda datës 15 prill, në format elektronik, listat e parashikuara në pikën 6.

8. Strukturat vartëse të MAS-it, brenda datës 10 maj:

a) të hartojnë listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor, bazuar në listat e parashikuara në pikat 4 dhe 7 për çdo njësi arsimore vendore;

b) t'u dërgojë njësive arsimore vendore listat përkatëse me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare.

9. Njësia arsimore vendore, brenda muajit maj, t'u dërgojë në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, të gjitha shkollave në juridiksionin e saj, në listën e parashikuar në pikën 8, të plotësuar me të dhënat e parashikuara në pikën 6.

10. Drejtorët e shkollave, brenda 3 ditëve pune pas datës së fillimit të vitit shkollor, t'u dërgojnë njësive arsimore vendore përkatëse, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, duke pasur parasysh përbërësit e parashikuar në pikën 1.

11. Çdo njësi arsimore vendore, bazuar në raportimet e shkollave, sipas pikës 10, brenda 5 ditëve pune nga njoftimet e shkollave, sipas pikës 10, të hartojë në format elektronik këto dokumente:

a) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonës që i takon çdo shkolle të arsimit bazë në juridiksion;

b) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë njësitë administrative përkatëse, sipas modelit të paraqitur te shtojca;

c) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë komisariatet përkatëse të policisë, sipas modelit të paraqitur te shtojca.

12. Çdo njësi arsimore vendore t'i dërgojë menjëherë, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe shefit të komisariatit përkatës të policisë dhe, për dijeni, prefektit përkatës, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në pikën 12/b/c dhe në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.

13. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 4 ditëve pune nga marrja në dijeni e shkresës zyrtare, të dërguar nga njësitë arsimore vendore, të parashikuar në pikën 11/a, duke pasur parasysh adresat e fëmijëve, të përcjellë për plotësim shtojcën te personi përgjegjës i njësisë administrative.

14. Shefi i Komisariatit të Policisë, brenda 4 ditëve pune nga marrja në dijeni të shkresës zyrtare të dërguar nga njësia arsimore vendore, të parashikuar në pikën 11/b, duke pasur parasysh adresën e fëmijës, të përcjellë për plotësim shtojcën te punonjësi i policisë së zonës.

15. Personi përgjegjës i njësisë administrative, brenda 6 ditëve pune nga marrja në dijeni e kërkesës nga kryetari i njësisë që qeverisjes vendore, të kryejë verifikimet në terren, të plotësojë shtojcën për çdo fëmijë dhe ta dërgojë te kryetari përkatës i njësisë së qeverisjes vendore.

Kryetari i njësisë që qeverisjes vendore të përcjellë menjëherë shtojcën e plotësuar te njësia arsimore vendore, nga e cila ka ardhur kërkesa, si dhe të informojë prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

16. Punonjësi i policisë së zonës, brenda 6 ditëve pune nga marrja në dijeni e kërkesës nga shefi përkatës i Komisariatit të Policisë, të kryejë verifikimet në terren, të plotësojë shtojcën për çdo fëmijë dhe ta dërgojë te shefi i Komisariatit të Policisë.

Shefi i Komisariatit të Policisë të përcjellë menjëherë shtojcën e plotësuar te njësia arsimore vendore, nga e cila ka ardhur kërkesa, si dhe të informojë prefektin, me shkresë zyrtare, për ecurinë e procesit.

17. Çdo njësi arsimore vendore, brenda datës 15 tetor, t'u dërgojë, në format elektronik ose edhe me shkresë zyrtare, shkollave që kanë raportuar fëmijë të paregjistruar, listën e fëmijëve me të dhënat e plotësuara nga përgjegjësi i njësisë së qeverisjes vendore dhe punonjësi i policisë së zonës dhe që i takojnë shkollës.

18. Shkollat publike, brenda muajit tetor, të regjistrojnë nxënësit e paregjistruar, që i përkasin zonës së tyre, bazuar në shkresën zyrtare të parashikuar në pikën 17.

19. Çdo njësi arsimore vendore, brenda datës 20 tetor, të hartojë listën e fëmijëve që nuk janë identifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative ose punonjësit e policisë së zonave ose që rezultojnë të transferuar dhe ta dërgojë në MAS.

20. Njësia arsimore vendore, brenda muajit tetor, të përmbledhë listat e parashikuara në pikën 20 dhe t'i dërgojë shkollës dhe strukturave të policisë për të marrë masat përkatëse për fëmijët ende të paidentifikuar, si dhe ata që janë transferuar.

SHTOJCA Nr.1

Udhëzim

- Te tabela A më poshtë vendosni shenjën "V" aty ku duhet.
  P.sh. kur familja e fëmijës nuk është më banore e zonës, vendosni shenjën "V" te kolona1.
- Vendosni shenjën "V" te kolona 3 kur, nga kërkimi juaj del se familja është transferuar, por nuk dihet se ku.
- Kur informoheni se familja e fëmijës është jashtë shtetit, shënoni "V" te kolona 4 dhe, po të gjeni edhe shtetin, shkruani edhe emrin e shtetit.
- Kur informoheni se ku është transferuar familja e fëmijës, vendosni te kutiza përkatëse të dhënat për vendin ku është transferuar.
- Te kolona 2, shkruani ku është transferuar familja e fëmijës. Lini bosh, kur nuk gjeni dot një të dhënë, p.sh. adresën e familjes.
- Te kolona 4 "Të tjera" shkruani çdo rast tjetër që nuk është parashikuar te kjo tabelë. P.sh. "Fëmija nuk është në gjendje të lëvizë"
- Te kolona "Burimi" shënoni se nga e morët informacionin për familjen e fëmijës ose për vetë fëmijën. P.sh. "Nga fqinji", "Nga vëllai i fëmijës" etj. Në çdo rast, shkruani emrin e burimit.

Për çdo fëmijë, do të plotësoni një tabelë.
Ju faleminderit për kontributin tuaj në të mirë të arsimit!

TABELA A

Tëdhënat e fëmijës		**1** **Familja nuk është më banore e zonës.**	**2** **Familja është transferuar në:**	**3** **Familja është transferuar, brenda vendit, por nuk dihet se ku.**	**4** **Familja është jashtë shtetit. Shëno shtetin.**	**5** **Të tjera informacione**	**6** **Burimi**
Emri			Qarku				
Mbiemri			Bashkia				
Emri i babait			Njësia Administrative				
Emri i nënës			Adresa				
Numri personal							
Gjinia							
Datëlindja							
Vendlindja							
Njësia administrative							

Hartuar nga _____ **Data**_____ **Firma**_____

FËMIJË QË DUHET TË NDJEKIN KLASËN E PARËDHE QË NUK NDODHEN NË LISTËN E DËRGUAR

Udhëzim

Përveç fëmijëve për të cilët ju plotësoni tabelën A, d.m.th. i dini emrin, emrin e babait etj., gjatë kërkimeve tuaja mund të zbuloni fëmijë të tjerë të cilët nuk janë regjistruar në klasën e parë. Ky do të jetë një kontribut tjetër i juaji për të ndihmuar që çdo fëmijë të nisë shkollën.

Do të duhet të pyesni sa më shumë banorë të zonës për të gjetur këta fëmijë.

- Te tabela më poshtë B, te kolona "Të dhënat e fëmijës" shkruani sa më shumë të dhëna që gjeni për fëmijën.
- Te kolona "Të tjerat" shkruani çdo informacion tjetër të vlefshëm për regjistrimin e fëmijës. P.sh. "Është në moshën 7 vjeç (ose 8 vjeç"), "Ka qenë në klasën e parë, por e ka braktisur" etj.
- Te kolona "Burimi" shënoni se nga e morët informacionin për fëmijën. P.sh. "Nga fqinji" , "Nga vëllai" etj.

Plotësoni aq tabela të mëposhtme sa fëmijë gjeni.

Ju falemindertl për kontributin tuaj në të mirë të arsimit!

TABELA B

Të dhënat e fëmijës		Të tjera	Burimi
Emri			
Mbiemri			
Emri i babait			
Emri i nënës			
Numri personal			
Gjinia			
Datëlindja			
Vendlindja			
Njësia administrative			

Hartuar nga_____ Data_____ Firma_____

***

UDHËZIM
Nr. 255, datë 3.11.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TARIFAVE PËR MARRËVESHJET E KRIJIMIT TË SERVITUTIT NË PUNIMET MINERARE NËNTOKËSORE HORIZONTALE

Në zbatim të nenit 102 , pika 4 , të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 pika 5 dhe 57 pika 4, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 , "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Servituti në punimet minerare nëntokësore horizontale, që i përkasin një zone tjetër ekzistuese të lejuar minerare, krijohet vetëm me marrëveshje mes palëve ndërmjet zotëruesit të lejes minerare ekzistuese, në të cilën gjenden punimet nëntokësore horizontale dhe zotëruesit të lejes minerare, i cili kërkon të përfitojë servitutin për bërë të mundur arritjen e trupit minerar.

2. Servituti në punimet minerare nëntokësore horizontale, krijon këto të drejta:

a) Të drejtën e kalimit në punimet nëntokësore horizontale që gjenden në zonën minerare që shfrytëzohet nga një subjekt i një leje tjetër minerare;

b) Të drejtën e kryerjes së punimeve nëntokësore në zona që përfshihen në zonën minerare që shfrytëzohet nga një subjekt i një leje tjetër minerare, me qëllim sigurimin e rrugëve të kalimit për të prekur trupin minerar, përfshirë edhe të drejtën e vendosjes së kabllove apo instalimeve të ndryshme;

c) Të drejta të tjera të parashikuara nga palët në marrëveshje.

3. Zotëruesi i lejes minerare mund të hyjë në një marrëveshje servituti me një subjekt tjetër minerar, për punimet horizontale nëntokësore, për lejet ekzistuese, në rastet kur:

a) Në projektin fillestar të paraqitur nga zotëruesi i lejes, e të miratuar nga struktura përgjegjëse, është përcaktuar që punimet e hapura nëntokësore horizontale ekzistuese ose pjesë të këtyre punimeve/punime ndihmëse, të cilat ndodhen jashtë zonës së lejuar do të shërbejnë si punime hapjeje horizontale edhe për zonën e tyre.

b) Edhe pse nuk është parashikuar në projektin fillestar, gjatë shfrytëzimit konstatohet, se punimet e hapjes janë përfshirë brenda zonës së rrezikshme, të krijuara si rezultat i kryerjes së punimeve të shfrytëzimit para marrjes së lejes nga ish-minierat shtetërore apo nga shfrytëzimi i subjekteve fqinje dhe lind nevoja që të hapen punime të reja horizontale fushore për të shfrytëzuar rezervat e mineralit, të cilat janë brenda zonës së subjektit.

II. Kushtet kryesore

1. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit sipas pikës 1:

a) Është i detyruar dhe ka përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe kryerjen e riparimeve të nevojshme në punimet nëntokësore që shfrytëzohen për kalim nga ana e tij. Kushtet konkrete të mirëmbajtjes, përfshirë edhe vlerat përkatëse monetare që duhet të paguajë zotëruesi i lejes minerare në funksion të riparimeve dhe të mirëmbajtjes së këtyre punimeve që përdoren për kalim, përcaktohen në marrëveshjen përkatëse të lidhur ndërmjet palëve.

b) Është i detyruar të respektojë të gjitha kushtet e përcaktuara në formatin e lejes minerar edhe në legjislacionin në fuqi për sektorin minerar.

c) Është i detyruar të respektojë rregullat e sigurimit teknik në punimet apo zonat nëntokësore që i përdor për kalim apo për kryerje te punimeve.

ç) Duhet t'i shfrytëzojë këto punime vetëm në funksion të së drejtës së kalimit dhe nuk duhet të prekë apo të cenojë materialet minerare të zbuluara ose jo nga subjekti tjetër minerar, që gjenden në këto zona minerare që përdoren për kalim.

d) Nuk duhet të cenojë sigurinë në punë të subjektit tjetër minerar. Gjithashtu, punimet nëntokësore që do të kryhen nga ana e zotëruesit të lejes minerare nuk duhet të pengojnë dhe të ndikojnë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë shfrytëzimin minerar të kësaj zone nga ana e subjektit tjetër minerar.

dh) Nuk duhet të shfrytëzojë mineraret që mund të zbulojë në zonën që i përket një leje tjetër minerare, zonë në të cilën kryen punime për të siguruar rrugë kalimi në mënyrë që të arrijë trupin minerar.

e) Në rast se nuk është parashikuar ndryshe në marrëveshje, subjekti tjetër minerar në zonën e lejes së të cilit do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, ka detyrimin që të realizojë riparimet thelbësore që përfaqësojnë mirëmbajtje të

rëndësishme të zonës përkatëse në të cilën do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit.

2. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit dhe subjekti tjetër minerar, në zonën e lejes së të cilit do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, vendosjes së kabllove etj., janë të detyruar që përpara marrëveshjes, të verifikojnë gjendjen e zonave në të cilat kërkohet që të krijohet e drejta e servitutit. Kur zona nuk përmbush kushtet e funksionimit dhe të sigurisë në punë, marrëveshja nuk mund të lidhet pa u normalizuar ato.

Në çdo rast, strukturat përgjegjëse kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e marrëveshjeve të tilla që kanë të bëjnë me krijimin e së drejtës së servitutit në zona me rrezikshmëri, në zona që i përkasin një lejeje tjetër minerare.

3. Kur nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve, servituti në punimet minerare nëntokësore, që i përkasin një zone tjetër ekzistuese minerare, ka afat të njëjtë me afatin e vlefshmërisë së lejes minerare përfituese dhe të lejes minerare ekzistuese.

4. Zotëruesi i lejes minerare që përfiton të drejtën e servitutit dhe subjekti tjetër minerar në zonën e lejes së të cilit do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, kanë përgjegjësi solidare për respektimin e rregullave të sigurimit teknik në zonën ku do të kalohet apo do të kryhen punime nëntokësore të kalimit, përveç rasteve kur përgjegjësitë ndahen në marrëveshjen e servitutit të nënshkruar ndërmjet palëve.

5. Zotëruesi i lejes minerare, që përfiton të drejtën e servitutit, është i detyruar që gjatë dorëzimit të programit vjetor të veprimtarisë minerare të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse edhe marrëveshjen përkatëse të servitutit. Marrëveshja e servitutit shqyrtohet nga struktura përgjegjëse në momentin e miratimit të programit vjetor, lidhur me çështjet e gjendjes teknike minerare dhe ndikimin e zonave të rrezikshme .

6. Strukturat përgjegjëse kanë të drejtë që të kërkojnë anulimin e marrëveshjes së servitutit ose ndryshimin e kushteve të saj, në rast se parashikon realizimin e së drejtës së servitutit në zona të rrezikshme.

III. Tarifat

1. Në funksion të realizimit nga struktura përgjegjëse, të përgjegjësive të parashikuara në pikat 5 dhe 6, të kapitullit II, të këtij urdhri, zotëruesi i lejes minerare , është i detyruar të paguajë vlerat përkatëse të shpenzimeve të nevojshme që i krijohen strukturës përgjegjëse.

Shpenzimet që do të paguhen, për llogari të strukturës përgjegjëse, për kryerjen e procedurave të kontrollit të punimeve, që kërkohen të jenë objekt i një servituti, të cilat paguhen nga subjekti zotërues i lejes minerare, përfitues i servitutit, janë të barabarta me shumën e përcaktuar në tarifat e miratuara të kryerjes së aktit të verifikimit gjatë procedurës së pajisjes me leje minerare shfrytëzimi.

2. Kur e drejta e servitutit nëntokësor është përcaktuar nga zotëruesi i lejes minerare dhe është miratuar nga struktura përgjegjëse në programin vjetor të veprimtarisë minerare, zotëruesi i lejes minerare, që përfiton të drejtën e servitutit, do t'i paguajë zotëruesit të lejes minerare për ushtrimin e të drejtës së servitutit, tarifa vjetore si më poshtë:

Nr.	Për punim mineral horizontal	Vlera e plotë për një vit
1	Për gjatësinë nga 0 - 100 ml	Lx 6000
2	Për gjatësinë nga 100 - 200 ml	(100 ml x 6000 lekë/ml) + (L-100) *5000
3	Për gjatësinë mbi 200 ml	(100 ml x 6000 lekë/ml) + (100 ml *5000 lekë/ml) + (L-200) ml *4000 lekë/ml

Shënim. L është gjatësia e punimit që i nënshtrohet servitutit

3. Kur është e detyrueshme që për hapjen e një punimi të kalohet nëpër zonën e një subjekti tjetër që ka leje minerare, ky punim përshtatet që të plotësojë edhe kërkesat e subjektit që lejon hapjen e punimit në zonën e tij dhe ky i fundit e përdor këtë punim pa pagesë.

4. Në tarifat e mësipërme përfshihet vetëm e drejta e kalimit në punimin nëntokësor horizontal dhe nuk përfshihen tarifa për përdorimin e infrastrukturës së prodhimit në sipërfaqe, si: sheshe depozitimi, rrugë tramozha, instalime mekanike etj., të cilat përcaktohen në marrëveshje ndërmjet palëve.

IV. Zbatimi i udhëzimit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, gjatë shqyrtimit të programit vjetor për zhvillimin e veprimtarisë minerare verifikon zbatimin e projekteve të miratuara për zhvillimin e aktiviteteve minerare në drejtimin e servitutit për punimet që janë miratuar që në projektin fillestar apo punimet e hapura rishtas për shkak të zonave të rrezikshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRISË
Damian Gjiknuri

VENDIM
Nr. 66, datë 17.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetari Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtari	“	“
Sokol Berberi	anëtari	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtari	“	“
Besnik Imeraj	anëtari	“	“
Fatos Lulo	anëtari	“	“
Fatmir Hoxha	anëtari	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.6.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 33 Akti, që i përket:

KËRKUES: Durim Sulkja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Elbasan, Zyra Përmbarimore “Çërraga”

OBJEKTI: Interpretim dhe plotësim i vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 28, 29 dhe 80 pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Durim Sulkja në datën 6.6.2014 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se nuk i është lidhur kontrata e shitjes së banesës në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka pretenduar se nuk ka mundur të lidhë kontratën e shitblerjes dhe se i është drejtuar disa herë Drejtorisë Rajonale të Entit të Banesave (DREB-së) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave (DPEKB-së) për lidhjen e saj. Për këtë arsye, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 10-2012-1538 (762) datë 23.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 30.3.2015, ka vendosur njëzëri rrëzimin e kërkesës.

3. Pas shpalljes së vendimit, kërkuesi në datën 10.4.2015 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të kësaj gjykate.

II

4. ***Kërkuesi Durim Sulkja*** ka kërkuar interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese si vijon:

4.1 Në paragrafin nr. 29 për fjalinë: *“Gjykata vlerëson se është kërkuesi që është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka ngritur disa herë pretendime të paarsyeshme”.*

4.2 Në paragrafin nr. 34 për fjalinë: *“Gjykata vlerëson se sjellja e autoriteteve, përfshirë edhe atë të subjektit të interesuar, nuk ka qenë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor”.*

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

5. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se për të ushtruar kompetencën e parashikuar në nenin 80, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” për interpretimin, plotësimin ose ndreqjen e gabimeve në vendimin saj, ajo mund të vihet në lëvizje vetëm nga palët pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes (*shih*

vendimet nr. 166, datë 20.6.2007; nr. 23, datë 23.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

6. Gjykata vëren se kërkuesi Durim Sulkja legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kësaj kërkese dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese është paraqitur në datën 10.4.2015, brenda afatit 2-mujor nga shpallja e vendimit, parashikuar nga neni 80, pika 1, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

B. Për themelin e pretendimit

7. Kërkuesi ka pretenduar interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese. Ai ka parashtruar se pretendimet e tij nuk mund të konsiderohen të paarsyeshme, pasi ato kanë qenë të lidhura me procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe me faktin se nga subjekti i interesuar janë përdorur dy standarde kontratash. Nga cenimi i së drejtës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor i është cenuar e drejta e pronësisë dhe e drejta për të lidhur kontratën e shitblerjes me pagesë të menjëhershme. Sipas kërkuesit, subjekti i interesuar nuk ka zbatuar një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk ka shfaqur vullnetin për të qenë i pranishëm pranë noterit për të nënshkruar kontratën e shitblerjes.

8. Gjykata, bazuar në nenin 80/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ka të drejtë ta interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen e këtij vendimi. Gjykata nuk mund të anulojë ose të ndryshojë vendimin e saj.

9. Gjykata konstaton se nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura në kërkesën për interpretim dhe plotësim të vendimit nuk ka rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e paragrafëve të vendimit, si dhe nuk ka ndonjë gabim apo pasaktësi në shkrim. Pretendimet e kërkuesit janë të lidhura me zgjidhjen e çështjes në themel dhe janë të njëjta me pretendimet e paraqitura me kërkesën e mëparshme, të cilat Gjykata Kushtetuese i ka shqyrtuar dhe i ka arsyetuar me vendimin nr. 15, datë 30.3.2015.

10. Gjykata çmon se paragrafët e vendimit, për të cilat kërkuesi ka pretenduar interpretimin dhe plotësimin, janë konkluzione të qarta të qëndrimit të mbajtur nga kjo gjykatë, e si të tilla nuk mund të ndryshohen apo të anulohen.

11. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit Durim Sulkja për interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese është haptazi e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM
Nr. 67, datë 17.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 18.6.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 30 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Fatos Prizreni

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 956 akti, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 437, datë 20.4.2012 të Gjykatës

së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-106, datë 23.1.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 25, 43 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 3, 6 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si edhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se shtetasi Sh.K. (vëllai i kërkuesit) është dënuar me vendimin nr. 116, datë 29.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me 4 (katër) vjet burgim për veprën penale "Vrasje me dashje", të mbetur në tentativë. Ky vendim është ekzekutuar në datën 3.2.2011.

2. Për shkak se ky shtetas vuante nga disa sëmundje, është dërguar që në momentet e para të ekzekutimit të dënimit në ambientet spitalore, fillimisht në Spitalin Rajonal të Shkodrës, më pas në Spitalin e Burgut Tiranë dhe së fundi në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", ku edhe ka ndërruar jetë në datën 22.2.2011.

3. Për këtë ngjarje, në datën 24.2.2011, ka bërë kallëzim Komisariati i Policisë nr. 4 Tiranë, i cili është regjistruar në regjistrin e Prokurorisë së Tiranës me nr. 1351. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, me vendimin e datës 13.4.2011, Prokuroria ka vendosur "*mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 1351 të vitit 2011*".

4. Në datën 24.4.2011 vendimi i është dërguar për dijeni vëllait të viktimës Sh.K. kërkuesit Fatos Prizreni, i cili në datën 17.5.2011 ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.

5. Me vendimin nr. 956 akti, datë 20.10.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *"Refuzimin e kërkesës së kërkuesit Fatos Prizreni me objekt: "Ankim kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal" si të pabazuar në ligj."*.

6. Me vendimin nr. 437, datë 20.4.2012 Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 956, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."* Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Me vendimin nr. 00-2014-106, datë 23.1.2014 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për arsye se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

8. ***Kërkuesi Fatos Prizreni*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, me pretendimin se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në këto drejtime:

8.1 Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, për shkak të interpretimit të gabuar që gjykatat i kanë bërë nenit 291 të KPP-së dhe anashkalimit të nenit 58 të KPP-së, i cili i njeh të dëmtuarit ose trashëgimtarëve të tij të drejtën për të kërkuar procedimin e fajtorit. Legjitimimin e kërkuesit për t'u ankuar e ka konfirmuar edhe vetë organi i akuzës, duke i dërguar atij, me shkresë të veçantë, në adresën e tij, vendimin për mosfillimin e procedimit penal, në të cilin është shprehur edhe e drejta për të paraqitur ankim në gjykatë brenda afatit ligjor.

8.2 Është cenuar e drejta për një ankim efektiv. Neni 13 i KEDNJ-së garanton të drejtën e individit për t'iu drejtuar një autoriteti të brendshëm për të kërkuar zgjidhje efektive lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa. Veçanërisht në rastet kur të afërmit e viktimës kanë dyshime lidhur me shkaqet e vdekjes së tij, kuptimi i një mjeti ligjor efektiv kërkon një hetim efektiv dhe tërësor për identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës, duke përfshirë edhe lirinë e të afërmve për të marrë pjesë në procedurat e hetimit.

8.3 Interpretimi që gjykatat i kanë bërë nenit 291/2 të KPP-së nuk përputhet me kuptimin dhe qëllimin e dispozitave të tjera që garantojnë të drejtat procedurale të palëve në një proces penal. Kjo mënyrë e ndryshme interpretimi dhe zbatimi e dispozitave procedurale ka sjellë për pasojë përjashtimin e kërkuesit nga e drejta e ankimit kundër vendimit të Prokurorisë.

9. ***Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar sa vijon:

9.1 Qëndrimi i mbajtur si nga ana e organit të akuzës, ashtu edhe nga gjykatat është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 291/2 të KPP-së dhe interpretimin që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë bërë kësaj dispozite.

9.2 Neni 290 i KPP-së përcakton në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve që kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për të kundërshtuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal dhe në këtë aspekt çdo zgjerim i rrethit të subjekteve nga gjykata do të nënkuptonte ndërhyrje në sferën legjislative. Nga ana tjetër, instituti i mosfillimit të procedimit (neni 290 i KPP-së) dhe ai i pushimit të çështjes (neni 328 i KPP-së) janë pothuajse të ngjashëm për nga pasojat që sjell vendimmarrja e organit procedues, që janë: mosvazhdimi i aktivitetit hetimor apo atij gjyqësor. Për pasojë, rregullimi i ndryshëm ligjor i institutit të ankimit ndaj vendimit të mosfillimit me atë të ankimit ndaj vendimit të pushimit, nuk rezulton të jetë në përputhje me natyrën e njëjtë të këtyre vendimeve.

9.3 Mosparashikimi i së drejtës së të dëmtuarit për t'u ankuar ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në rastet kur ai nuk ka qenë kallëzuesi i veprës penale, i jep natyrë antikushtetuese nenit 291/2 të KPP-së, pasi një pohim i qartë dhe shterues mbart në vetvete ndalimin e subjekteve të tjera për t'iu drejtuar gjykatës. Në këtë kuptim, gjykatat kishin detyrimin që të bënin vlerësimin kushtetues të kërkesës, duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar kushtetueshmërinë e përmbajtjes së nenit 291/2 të KPP-së.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

11. Kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës së aksesit, për arsye se, sipas tij, gjykatat kanë bërë një interpretim të gabuar të nenit 291 të KPP-së, si edhe kanë anashkaluar nenin 58 të KPP-së, i cili i njeh të dëmtuarit ose trashëgimtarëve të tij të drejtën për të kërkuar procedimin e fajtorit. Po ashtu, ai pretendon se kjo mënyrë e ndryshme interpretimi dhe zbatimi e dispozitave procedurale ka sjellë për pasojë përjashtimin e kërkuesit nga e drejta e ankimit kundër vendimit të Prokurorisë.

12. Gjykata i vlerëson të dyja këto pretendime të kërkuesit në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimin nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces,

por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 52, datë 14.11.2014; nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet. Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Asnjëherë nuk përjashtohet mundësia që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 7, datë 27.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. GJEDNJ-ja është shprehur se interpretimi i ngushtë i së drejtës së aksesit, që garantohet nga neni 6, § 1 i KEDNJ-së, nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e këtij parashikimi. Rëndësia e ushtrimit të të drejtave procedurale ndryshon në varësi të qëllimit të veprimeve, të cilat personi në fjalë synon t'i ushtrojë para gjykatave (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Nataliya Mikhaylenko kundër Ukrainës, nr. 49069/11, 30 maj 2013, §37*).

16. Gjykata vëren se kërkuesi, në cilësinë e vëllait të viktimës SH.K., pasi është njohur me vendimin e organit të akuzës për mosfillimin e procedimit penal, lidhur me kallëzimin për shkaqet e vdekjes së viktimës, i është drejtuar gjykatës për kundërshtimin e këtij vendimi dhe ka kërkuar vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, në bazë të neneve 290 dhe 291 të KPP-së.

17. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 956 akti, datë 20.10.2011, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin dhe në interpretim të dispozitave procedurale të zbatueshme në çështjen në fjalë, ka vlerësuar se subjektet procedurale që mund të kundërshtojnë në gjykatë këtë lloj vendimi janë personat që kanë bërë ankim ose kallëzim. Sipas gjykatës, në kushtet kur procedimi penal ka nisur mbi kallëzimin e Komisariatit të Policisë nr. 4 dhe kërkuesi nuk ka paraqitur as kallëzim dhe as ankim për shkaqet e vdekjes së vëllait të tij, ai nuk legjitimohet në paraqitjen e këtij ankimi, pavarësisht lidhjes së tij me viktimën.

18. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se interpretimi i ligjit procedural është atribut i gjykatave të sistemit gjyqësor dhe i organeve që e zbatojnë atë. Nisur nga ky parim, edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të kodeve përkatëse të Procedurës, edhe raporti me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Megjithatë, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej kësaj Gjykate, por vetëm nëse përmes këtij procesi cenohet e drejta kushtetuese themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Neni 291 i KPP-së parashikon se: *"1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit."* Gjykata vëren se sipas kësaj dispozite i është njohur e drejta e ankimit në të tilla raste vetëm kallëzuesit ose personit që ka bërë ankim, pra personit që ka vënë në lëvizje organin e akuzës, dhe ka iniciuar procedimin penal. Instituti i ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal është interpretuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 2, datë 20.6.2013, të cilat janë shprehur se: *"faza e fillimit të procedimit penal është e lidhur kryesisht me verifikimin e kushteve dhe të rrethanave që nuk lejojnë fillimin e hetimeve në drejtim të personit të dyshuar apo atij të cilit i atribuohet kryerja e*

veprës penale. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal nuk prek interesat e personit që i atribuohet vepra penale. Në këtë kuptim, nuk mund të ketë ndonjë arsye që ky person të bëjë ankim kundër vendimit të mosfillimit. Në bazë të nenit 291 të KPP-së, të legjitimuar për të paraqitur ankim janë vetëm kallëzuesi ose i dëmtuari ankues, sipas përcaktimeve të parashikuara prej nenit 284 të KPP-së. Të drejtën e ankimit dhe për rrjedhojë edhe legjitimimin për të ankimuar vendimin e mosfillimit, Kodi i Procedurës Penale ia njeh, përveç subjektit të "dëmtuar akuzues", që në bazë të nenit 58 të KPP-së si pasojë e veprës penale ka të drejtë të paraqesë kërkesë për fillimin e procedimit penal dhe të ngrejë akuzë drejtpërsëdrejti në gjykatë, edhe atyre subjekteve të dëmtuara pa ankimin e të cilëve nuk mund të fillojë procedimi penal e kur ka filluar nuk mund të vazhdojë, në bazë të nenit 284 të KPP-së. Për më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke qartësuar, arrijnë në konkluzionin logjik se sipas nenit 291/2 të KPP-së prokurori duhet t'i njoftojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duke i dhënë mundësinë për t'u ankuar kundër këtij vendimi, kallëzuesit të veprës penale, i cili mund të jetë, rast pas rasti, edhe i dëmtuari nga vepra penale, si edhe ankuesit, kur ka të tillë, në kuptim të nenit 284 të KPP-së."

20. Gjykata vëren se sipas nenit 58 të KPP-së personi i dëmtuar ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e autorit dhe shpërblimin e dëmit, kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojnë marrjen e provave. Në këtë kuptim, kërkuesi apo familjarët e tjerë të viktimës nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore që të kërkonin të dhëna dhe informacione nga organi i akuzës apo që të paraqisnin kallëzim për shkak të dyshimeve për shkaqet e vdekjes së viktimës SH.K. Për sa kohë që kërkuesi nuk ka vënë në lëvizje organin e akuzës për fillimin e procedimit penal, ai nuk legjitimohet në paraqitjen e ankimit ndaj këtij vendimi. Edhe pse në dukje dispozita e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale cenon të drejtën e aksesit, duke e parë këtë dispozitë në harmoni me dispozitat e tjera të KPP-së si dhe me përfundimet e vendimit nr. 2, datë 20.6.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se nuk preket në thelb e drejta e aksesit.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit

21. Kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës për një ankim efektiv. Sipas tij, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së në rastet kur të afërmit e viktimës kanë dyshime lidhur me shkaqet e vdekjes së tij, kuptimi i një mjeti ligjor efektiv kërkon një hetim efektiv dhe tërësor për identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës, duke përfshirë edhe lirinë e të afërmve për të marrë pjesë në procedurat e hetimit. Interpretimi që gjykatat i kanë bërë nenit 291/2 të KPP-së nuk përputhet me kuptimin dhe qëllimin e dispozitave të tjera që garantojnë të drejtat procedurale të palëve në një proces penal, duke sjellë përjashtimin e kërkuesit nga e drejta e ankimit kundër vendimit të Prokurorisë.

22. Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, mbi bazën e parashikimit kushtetues, është rregulluar edhe nga dispozitat materiale e procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kushtetuta i garanton individit të drejtën për t'u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij në një gjykatë më të lartë. Gjykata ka theksuar se e drejta themelore e ankimit është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se *"...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit"* ose*"...nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë" (shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka ushtruar të drejtën kushtetuese të ankimit. Atij i është njohur e drejta të kundërshtojë vendimin gjyqësor që ka vendosur moslegjitimimin e tij për kundërshtimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal në të gjitha shkallët e ankimit, ankim që është marrë në shqyrtim nga gjykatat më të larta duke iu dhënë përgjigje e argumentuar pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Për këtë arsye edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të

Kushtetutës, janë haptazi të pabazuara për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

MENDIM PAKICE

1. Jam i mendimit se kërkesa e shtetasit Fatos Prizreni, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, duhej pranuar për arsyet e mëposhtme.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se vëllai i kërkuesit, i dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale, ka ndërruar jetë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Prokuroria e Tiranës, mbi bazën e kallëzimit të Komisariatit të Policisë nr. 4, Tiranë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me ngjarjen në fjalë. Një kopje e këtij vendimi i është komunikuar kërkuesit, i cili ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë refuzuar ankimin e kërkuesit, duke arsyetuar se bazuar në nenin 291 të KPP-së, ai nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal të prokurorisë, përderisa ai nuk është subjekti që ka paraqitur kallëzim apo ankim. Për pasojë, kërkuesi i është drejtuar kësaj Gjykate duke pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë për shkak të interpretimit të gabuar që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë bërë nenit 291 të KPP-së, si dhe për shkak të anashkalimit prej tyre të nenit 58 të KPP-së, i cili i njeh të dëmtuarit ose trashëgimtarëve të tij të drejtën për të kërkuar procedimin e fajtorit.

4. Shumica në vendimin e saj edhe pse pranon se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej kësaj Gjykate, por vetëm nëse përmes këtij procesi cenohet e drejta kushtetuese themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih paragrafin 18 të vendimit*), nuk i shmanget interpretimit të ngushtë të neneve 58 dhe 291 të KPP-së, të bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

5. Shumica ka vërejtur se sipas nenit 291 të KPP-së, e drejta e ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit i është njohur vetëm kallëzuesit ose personit që ka bërë ankim, pra personit që ka vënë në lëvizje organin e akuzës, dhe ka iniciuar procedimin penal. Ndërsa sipas nenit 58 të KPP-së, arsyeton shumica, personi i dëmtuar ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e autorit dhe shpërblimin e dëmit, kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojnë marrjen e provave. Në këtë kuptim, kërkuesi apo familjarët e tjerë të viktimës nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore që të kërkonin të dhëna dhe informacione nga organi i akuzës apo të paraqisnin kallëzim për shkak të dyshimeve për shkaqet e vdekjes së viktimës SH.K. Për këto arsye, shumica ka arritur në përfundimin se për sa kohë që kërkuesi nuk ka vënë në lëvizje organin e akuzës për fillimin e procedimit penal, ai nuk legjitimohet në paraqitjen e ankimit ndaj këtij vendimi. Ajo (shumica), duke u bazuar edhe në përfundimet e vendimit nr. 2, datë 20.6.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar se nuk preket në thelb e drejta e aksesit të kërkuesit (*shih paragrafët 19-20 të vendimit*).

6. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret një trajtim i tillë i ngushtë formal-juridik i problemit më thelbësor në këtë çështje, duke u kufizuar thjesht në interpretimin e nenit 291 të KPP-së, lë jashtë vëmendjes elementin më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, respektimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

7. Sikurse konstaton edhe shumica, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e

drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese).* Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Ky qëndrim i Gjykatës është në një linjë me qëndrimet tashmë të konsoliduara të GJEDNJ-së apo gjykatave të tjera simotra. GJEDNJ-ja, që në vitin 1975, në çështjen *Golder kundër United Kingdom* (çështja 4451/70, vendimi datë 21.2.1975, par. 35), është shprehur se "*do të ishte e pakonceptueshme, sipas mendimit të Gjykatës, që neni 6 par. 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojë në radhë të parë atë që në fakt bën të mundur përfitimin e garancive të tilla, që është aksesi në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia, nuk do të kenë fare vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore".* Pra, duke bërë një interpretim të të "drejtave efektive", GJEDNJ-ja në vendimin Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar përcaktoi se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor[1].

10. GJEDNJ-ja edhe në çështjen *McElhinney kundër Irlandës* (aplikimi nr. 31253/96, par. 33), si dhe në çështjen *T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (aplikimi nr. 28945/95, par. 96), ka ritheksuar e drejta e aksesit "*është një aspekt i pandarë i garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe të shmangies së pushtetit arbitrar, që qëndrojnë në themel të Konventës. Kështu, neni 6 § 1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të pasur çfarëdo pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykate".*

11. Ndërsa Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur se "gjykatat nuk mund të injorojnë detyrimin për të respektuar të drejtën e aksesit të individit në gjykatë, përkundrazi ato kanë detyrimin ta respektojnë atë në çdo moment dhe të marrin të gjitha masat që ajo të realizohet **pavarësisht situatës juridike"** (BVerfGE 29, 45).

12. Nga sa më lart, ndryshe nga shumica, jam i mendimit se në aspektin kushtetues, edhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t'u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Pra, edhe pse si çdo e drejtë tjetër edhe e drejta e aksesit në gjykatë mund t'u nënshtrohet kufizimeve, ato duhet të jenë deri në atë masë sa të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Çka do të thotë se në balancën ndërmjet së drejtës së aksesit dhe mënyrës së interpretimit të ligjit, e drejta e aksesit duhet të mbizotërojë.

13. Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm brenda hapësirës së juridiksionit të tyre, në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

[1] Shih *The European Convention on Human Rights, Jacobs & White, Oxford, Fourth Edition*, f. 170.

dhe të parimit të kushtetutshmërisë, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve janë të detyruara të bëjnë një interpretim pajtues të ligjit që duhet tëzbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete me standardet kushtetuese. Gjykata ka theksuar tashmë se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë gjyqësor, lipset që kjo gjykatë, në përputhje edhe me nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, të mos kufizohet vetëm në dispozitat e këtij Kodi, por të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse kjo nuk është e mundur, në rast se nga interpretimi i ligjit konkret cenohen standardet kushtetuese (e drejta e aksesit në çështjen në gjykim), gjyqtari/gjyqtarët duhet t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar antikushtetutshmërinë e ligjit.

14. Në rastin në shqyrtim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë zbatimit të dispozitës së nenit 291 të KPP-së, nuk kanë bërë asnjë përpjekje për ta interpretuar atë në harmoni me dispozitat e tjera procedurale penale si dhe me frymën e Kushtetutës dhe as kanë kërkuar në rrugën e kontrollit incidental kushtetutshmërinë e normës juridike në fjalë. Ato nuk kanë mbajtur në konsideratë as qëndrimin e organit të akuzës, i cili, nëpërmjet njoftimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal familjarëve të viktimës dhe, për pasojë, njohjes atyre të së drejtës së ankimit ndaj këtij vendimi, ka bërë *de facto* edhe një interpretim pajtues të dispozitave të neneve 58 dhe 291 të KPP-së me Kushtetutën. Gjithashtu, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për të arritur në një përfundim sa më të drejtë lidhur me zgjidhjen e çështjes, nuk kanë marrë parasysh as faktin se mosfillimi i procedimit penal, në thelb, ka të bëjë me mosprocedimin e fajtorit të veprës penale dhe se në këtë drejtim neni 58 iKPP-së ia njeh këtë të drejtë (procedimin e fajtorit) të dëmtuarit ose trashëgimtarëve të tij (si në rastin në fjalë). Përkundrazi, gjykatat kanë zgjedhur "rrugën më të shkurtër", atë të interpretimit të ngushtë të nenit 291 të KPP-së, sipas të cilit e drejta e ankimit lidhet detyrimisht me faktin e vënies në lëvizje të organit të akuzës për fillimin e procedimit penal. Kësaj të mete nuk ka mundur t'i shmanget as shumica në arsyetimin e vendimit të saj.

15. Po në këtë kontekst, përpjekjet e shumicës për të mbështetur arsyetimet e veta në vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të pabazuara dhe të pavend. Në vlerësimin tim ky vendim nuk mund t'i shërbejë kësaj Gjykate për të vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, pjesë e të cilit janë edhe Kolegjet e Bashkuara. Për më tepër, ky vendim në vetvete është kontradiktor, pasi edhe pse njeh si subjekte të procedimit penal edhe të dëmtuarin (*shih pikën 9 të vendimit unifikues*), këtij të fundit i njeh të drejtën e ankimit vetëm ndaj vendimit të pushimit të çështjes (*shih pikën 30 të vendimit unifikues*) dhe jo ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, pavarësisht ngjashmërive ndërmjet këtyre dy instituteve të konfirmuara në vendimin unifikues (*shih pikën 24 të vendimit unifikues*).

16. Për këto arsye jam i mendimit se kushtëzimi i së drejtës së të dëmtuarit, ose i trashëgimtarëve të tij, për t'u ankuar ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal vetëm në rastet kur ai ka qenë kallëzues i veprës penale, i cenon atij të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Në këtë këndvështrim çmoj se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të synonin t'i jepnin një zgjidhje ankimit të kërkuesit duke zbatuar drejtpërdrejt Kushtetutën (interpretim pajtues të neneve 58 dhe 291 të KPP-së me Kushtetutën) apo t'i kërkonin kësaj Gjykate të vlerësonte kushtetutshmërinë e parashikimit ligjor konkret, nenit 291/2 të KPP-së. Në rastin në shqyrtim, sikurse u theksua më lart, përderisa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë përmbushur këtë detyrim, ngelej detyrë e kësaj Gjykate të qartësonte kuptimin e dispozitës konkrete në pajtim me standardet kushtetuese.

17. Si përfundim, vlerësoj se në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke mos pranuar ankimin e kërkuesit, i kanë cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM
Nr. 68, datë 17.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetari Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtari	“	“
Sokol Berberi	anëtari	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtari	“	“
Gani Dizdari	anëtari	“	“
Fatos Lulo	anëtari	“	“
Besnik Imeraj	anëtari	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 23.6.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 32 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Imerr Hoxha

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1841, datë 20.9.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si edhe nr. 00-2014-4075, datë 30.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dhoma e këshillimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si edhe nenet 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se me vendimin nr. 411, datë 29.1.2001 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Dibër, dalë në bazë të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për trajtimin e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, kërkuesit Imerr Hoxha i është njohur e drejta për të përfituar trajtim të veçantë si punonjës që ka punuar në miniera në nëntokë.

2. Pas përfundimit të procesit të auditivit, të kryer nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendimin nr. 411/1, datë 25.1.2010, DRSSH-ja Dibër ka vendosur mbylljen e efekteve financiare të dosjes së përfitimit të kërkuesit, duke i bërë atij të ditur edhe shumën e përfituar padrejtësisht.

3. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës së juridiksionit të zakonshëm me padi me objekt: detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër të fillojë pagimin e pensionit të pezulluar padrejtësisht nga data 1.1.2009, si dhe detyrimin për pagimin e shumës prej 6.400 lekësh në muaj, që i përket periudhës 10-mujore nga dita e pezullimin të pensionit.

4. Me vendimin nr. 303, datë 25.6.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë së paditësit Imerr Hoxha, si të pabazuar në ligj dhe në prova*”.

5. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 1841, datë 20.92011 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Me vendimin nr. 00-2014-4075, datë 30.10.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Imerr Hoxha.

II

7. ***Kërkuesi Imerr Hoxha*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit, me pretendimin se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

7.1 Është cenuar parimi i kontradiktoritetit , si edhe e drejta e mbrojtjes, si elemente të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor. Gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë në mungesë të kërkuesit, pasi kjo gjykatë nuk ka bërë njoftimin për pjesëmarrjen në gjykim me shpallje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si edhe me fletëthirrje, siç parashikon neni 460/3 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7.2 Njoftimi me shpallje është i mangët dhe nuk është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural, duke i cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes në gjykim.

7.3 Edhe pse kjo shkelje u ngrit nga kërkuesi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kjo e fundit nuk e mori parasysh atë.

8. ***Subjekti i interesuar, DRSS-ja, Dibër,*** në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar sa vijon:

8.1 Është provuar se kërkuesi ka falsifikuar dokumentin zyrtar kundrejt përfitimit të paligjshëm të trajtimit të veçantë.

8.2 Pretendimet e kërkuesit për procesin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë janë të pabazuara, pasi gjykata u ka dhënë mundësi palëve ndërgjyqëse të parashtrojnë pretendimet e tyre dhe të paraqesin prova në mbrojtje të këtyre pretendimeve, duke i administruar dhe vlerësuar ato sipas bindjes së brendshme.

8.3 I pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesit për mosmarrjen dijeni për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit. Siç konstatohet edhe nga përmbajtja e këtij vendimi, subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Dibër, ka qenë i pranishëm në shqyrtimin e çështjes në atë gjykatë, çka provon se njoftimi për datën dhe orën e gjykimit është realizuar rregullisht për palët ndërgjyqëse.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur

10. Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të kontradiktoritetit, si edhe të së drejtës së mbrojtjes në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak të mosnjoftimit të tij për datën dhe orën e seancës gjyqësore, në përputhje me dispozitat procedurale.

11. Gjykata në jurisprudencë konstante ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë, që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim iu paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 51, datë 21.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet

ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 31, datë 26.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka vlerësuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës, mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërish në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka theksuar edhe se veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës) (*shih vendimin nr. 48, datë 29.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në referim të nenit 460 të KPC-së njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ankimuar. Po ashtu, kjo dispozitë përcakton edhe se afati kohor për njoftimin e palëve është 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.

16. Në çështjen konkrete në shqyrtim Gjykata vëren se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, është zhvilluar pa praninë e palëve. Në seancën e datës 20.9.2011 Gjykata e Apelit Tiranë pasi ka bërë verifikimin e paraqitjes së palëve, ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuesit, me arsyetimin se kërkuesi ka pasur dijeni (*procesverbali i datës 20.9.2011, fq1. e dosjes gjyqësore*). Sipas vërtetimit nr. 925 prot., datë 22.9.2011, të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, rezulton se në listën e gjyqeve të datës 20.9.2011 të Gjykatës së Apelit Tirane nuk është listuar çështja civile me palë paditëse kërkuesin Imerr Hoxha. Po ashtu, edhe në materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton i administruar ndonjë njoftim për kërkuesin në lidhje me datën dhe orën e seancës gjyqësore.

17. Gjykata vlerëson se ishte detyrë e Gjykatës së Apelit të Tiranës të verifikonte nëse njoftimi i palëve ishte bërë në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me nenin 460 të KPC-së. Mospërmbushja nga ana e kësaj gjykate e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat procedurale për njoftimin e rregullt të kërkuesit për datën dhe orën e seancës gjyqësore në atë gjykatë, ka sjellë për rrjedhojë, cenimin e së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së palëve. Po ashtu, Gjykata vëren se ndonëse pretendimi si m ë sipër është ngritur nga kërkuesi edhe në rekursin drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ky i fundit si gjykatë ligji duhet t'i konstatonte këto shkelje duke i korrigjuar ato.

18. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mohimit të së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes, objekt shqyrtimi, në Gjykatën e Apelit të Tiranës, për shkak të mosnjoftimit të datës dhe orës së gjykimit, janë të bazuara, për rrjedhojë kërkesa për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash[2],

VENDOSI:

- Pranimin tërësisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimeve nr. 1841, datë 20.9.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2014-4075, datë 30.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

[2] Gjyqtarja V. Tusha votoi vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM
Nr. 69, datë 17.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetari Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtari	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtari	"	"
Gani Dizdari	anëtari	"	"
Besnik Imeraj	anëtari	"	"
Fatos Lulo	anëtari	"	"
Vladimir Kristo	anëtari	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.10.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 55 Akti, që i përket:

KËRKUES: Arif Muka

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Enti Kombëtar i Banesave Tiranë, Bashkia Vorë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-4241 (619), datë 20.11.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 134/1/g dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; nenet 12/3 dhe 60/2 të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është banor i fshatit Gërdec të Bashkisë Vorë. Në shkurt të vitit 2008, si rezultat i aksidentit teknologjik të Gërdecit, familja e tij pati dëme të rënda materiale në objektet e banimit dhe në ato të aktivitetit privat. Bazuar në VKM-në nr. 315, datë 21.3.2008 për konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve të pësuara, Komisioni i Vlerësimit të Dëmeve ka përgatitur Formularin F1 për dëmet në objekt nga ana ndërtimore dhe strukturore dhe Formularin F2 për listën e orendive dhe pajisjeve të dëmtuara, të cilat u përpiluan edhe për kërkuesin. Këta formularë i janë përcjellë Entit Kombëtar të Banesave për procedurën e kompensimit të dëmeve, i cili ka bërë përllogaritjen e dëmeve.

2. Kërkuesi nuk ka qenë dakord me përllogaritjen e dëmit të kryer nga Enti Kombëtar i Banesave për objektin ku ushtron aktivitetin privat. Për këtë arsye i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjekteve të interesuar, palë të paditura në atë gjykim, t'i paguajnë dëmin e llogaritur si diferencë midis dëmit të shkaktuar dhe vlerës së tyre të pasqyruar në formularët F1 dhe F2.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 905, datë 11.2.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit si të pabazuar në ligj dhe në prova.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr. 2823, datë 23.12.2011, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë si më poshtë: pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e subjekteve të interesuara Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave t'i paguajnë kërkuesit vlerën prej 2.500.000 lekësh si diferencë midis llogaritjes së Formularëve F1 + F2 dhe vlerës së përcaktuar nga akti i ekspertimit për dëmin total të shkaktuar.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-4241 (619), datë 20.11.2014, mbi ankimin e subjekteve të interesuara, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2823, datë 23.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 905, datë 11.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II

6. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata") për shfuqizimin e vendimit objekt kërkese me pretendimin se:

6.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar nenin 42 të Kushtetutës për shkak të mosformimit të drejtë të trupit gjykues, pasi e ka shqyrtuar çështjen me tre gjyqtarë. Ai nuk ka respektuar nenin 12/3 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (ligji 49/2012), i cili parashikon se trupi gjykues në këto raste duhet të përbëhet nga pesë gjyqtarë.

6.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit prej gjykatës ku është depozituar.

6.3 Është cenuar neni 42 i Kushtetutës, sepse nuk është kryer një gjykim publik me pjesëmarrjen e palëve, pasi gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë është bërë në dhomën e këshillimit.

7. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka parashtruar me shkrim këto prapësime:

7.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar çështjen me tre gjyqtarë konform nenit 12/3 të ligjit nr. 49/2012 të ndryshuar.

7.2 Kërkuesi, konform jurisprudencës kushtetuese, nuk ka arritur të provojë nëse Kolegji Administrativ me veprime ose mosveprime që lidhen me rastin në fjalë nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të marrë të gjitha masat me qëllim moszvarritjen e procesit. Është fakt i njohur botërisht që gjykimet në Gjykatën e Lartë vonohen. Rasti objekt shqyrtimi nuk ka qenë i ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm.

7.3. Gjykimi në dhomë këshillimi nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk u bie ndesh standardeve të jurisprudencës kushtetuese dhe ligjit nr. 49/2012.

8. *Subjektet e interesuara, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave,* kanë prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

8.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka zbatuar nenin 12/3 të ligjit nr. 49/2012 të ndryshuar kur ka gjykuar çështjen me tre gjyqtarë.

8.2 Rekursi i Ministrisë së Financave është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 21.3.2012, pra para hyrjes në fuqi të ligjit për gjykatat administrative. Për këtë arsye kërkuesi nuk mund të kërkojë që rekursi të shqyrtohet brenda afatit kohor të 90 ditëve.

8.3 Gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Kolegji Administrativ mund të vendosë të thërrasë palët në seancë gjyqësore nëse e gjykon të nevojshme, por kjo nuk përbën detyrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për parimin e gjykatës së caktuar me ligj

10. Kërkuesi pretendon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi me tre gjyqtarë, edhe pse neni 12/3 i ligjit nr. 49/2012 të lartpërmendur parashikon se trupi gjykues në këto raste duhet të përbëhet nga pesë gjyqtarë.

11. Lidhur me pretendimin për formimin e drejtë të trupit gjykues Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj" është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Termi "gjykatë" karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej

ligjit (*shih vendimet nr. 16 datë 27.3.2012, nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata konstaton se neni 12/3 i ligjit nr. 49/2012 fillimisht parashikonte se Gjykata e Lartë gjykonte në Kolegj Administrativ me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikonte ndryshe. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 100, datë 31.7.2014, neni 12/3 i ligjit nr. 49/2012 aktualisht parashikon se *"Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë"*. Ndërkohë, neni 12/1 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se *"Gjykata administrative e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë mosmarrëveshjet lidhur me kontratat administrative publike dhe kërkesat e paraqitura në zbatim të shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 7 të këtij ligji. Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar"*. Nga dispozitat e lartpërmendura rezulton se është objekti i mosmarrëveshjes së çështjes, i cili përcakton përbërjen e trupit gjykues në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe, për pasojë, atë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

13. Gjykata, gjithashtu, vëren se ndryshimet e lartpërmendura, të bëra në nenin 12/3 të ligjit nr. 49/2012, me anë të ligjit nr. 100, datë 31.7.2014, kanë hyrë në fuqi në datën 15.9.2014, pra përpara shqyrtimit të çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi në datën 20.11.2014. Për pasojë, Gjykata vlerëson se përderisa objekti i mosmarrëveshjes në fjalë sipas nenit 12/1 të ligjit nr. 49/2012 duhet të gjykohet nga një gjyqtar i vetëm, kompetenca për shqyrtimin e saj, sipas nenit 12/3 të ligjit 49/2012 të ndryshuar, i përket një trupi gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

14. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se gjatë shqyrtimit të çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë trupi gjykues është formuar konform parashikimeve ligjore të nenit 12/3 të ligjit nr. 49/2012 të ndryshuar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar.

C. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesi pretendon se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit prej gjykatës ku ai është depozituar. Nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2012 dhe gjykimi është bërë në vitin 2014, pra jashtë afatit ligjor të lartpërmendur.

16. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, lidhur me këtë pretendim ka prapësuar se edhe pse ligji nr. 49/2012 ishte një nevojë e domosdoshme për arritjen e standardeve të gjithë pranuara, shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë është ngarkesa e trashëguar në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit. Ndërsa, subjektet e interesuara, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, kanë prapësuar se rekursi i Ministrisë së Financave është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 21.3.2012, pra para hyrjes në fuqi të ligjit për gjykatat administrative, prandaj kërkuesi nuk mund të kërkojë që rekursi të shqyrtohet brenda afatit kohor të 90 ditëve.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.7.2005; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së

drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të vlerësohet analiza e secilit prej elementeve të sipërcituara.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

19. Lidhur me periudhën e *kohës që duhet marrë në konsideratë*, Gjykata vëren se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2012 dhe gjykimi është bërë në vitin 2014, ndonëse neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin prej 90 ditësh për shqyrtimin e çështjes nga kjo Gjykatë.

ii) Kompleksiteti i çështjes

20. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin në shqyrtim konstatohet se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Objekti i saj lidhet me vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kërkuesit. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkuesit

22. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

23. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit *"gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme",*dhe në nenin 171/a të KPC-së,sipas të cilit *" gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj" (shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata konstaton se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 të lartpërmendur, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin bashkëlidhur projektligjit nr. 49/2012 thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata, gjithashtu, vëren se në relacionin e projektligjit të lartpërmendur lexohet se afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60/2 në shqyrtim).

25. Nga sa më lart, Gjykata çmon se përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta.

26. Në këtë këndvështrim Gjykata çmon se prapësimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht.

27. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij, ose e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Për rrjedhojë, edhe prapësimi i subjekteve të interesuara, Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, se kërkuesi nuk mund të kërkojë që rekursi të shqyrtohet brenda afatit kohor të 90 ditëve, pasi ai është regjistruar në Gjykatën e Lartë para hyrjes në fuqi të ligjit për gjykatat administrative, nuk është i bazuar.

28. Për këto arsye, Gjykata arrin në përfundimin se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt, për shkak se çështja në këtë Gjykatë nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm siç parashikohet dhe në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012.

D. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi

29. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se është cenuar neni 42 i Kushtetutës, sepse nuk është kryer një gjykim publik me pjesëmarrjen e palëve, për shkak se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë është bërë në dhomën e këshillimit.

30. Gjykata është shprehur edhe herë të tjera për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative në nenin 61 ka përcaktuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi dhe në nenin 62 ka parashikuar se cilat janë, përjashtimisht, rastet e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për pasojë, Gjykata vlerëson se gjykimi i çështjes në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore është atribut i vetë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Përderisa kërkuesi nuk pretendon se çështja objekt shqyrtimi hyn në rastet e parashikuara nga neni 62 i ligjit nr. 49/2012, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

32. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha,Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtare kundër: Vitore Tusha,

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice, sepse nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosshqyrtimit të çështjes nga Kolegji Administrativ brenda afatit ligjor (*pika 1 e dispozitivit të vendimit*).

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë me objekt *"Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-4241 (619), datë 20.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë"*, duke argumentuar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegjin Administrativ nuk janë respektuar disa standarde të procesit të rregullt ligjor, si gjykata e caktuar me ligj, zhvillimi i procesit brenda afatit të arsyeshëm dhe publiciteti i seancës gjyqësore.

3. Nga rrethanat e çështjes konstatohet se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë nuk është vënë në lëvizje nga kërkuesi, por nga subjektet e interesuara. Në përfundim të këtij procesi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-4241 (619), datë 20.11.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2823, datë 23.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 905, datë 11.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Shumica, pasi ka analizuar pretendimet e kërkuesit, që lidhen me cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe mosrespektimin e publicitetit të gjykimit, me të drejtë i ka vlerësuar ato si të pabazuara. Ky vlerësim i shumicës, me të cilin jam dakord, nënkupton se gjatë procesit të zhvilluar në Kolegjin Administrativ nuk ka pasur shkelje të natyrës procedurale, për rrjedhojë nuk mund të vihet në dyshim zhvillimi i këtij procesi në kundërshtim me standardet e procesit të rregullt.

5. Në lidhje me pretendimin për mosrespektimin e standardit kushtetues të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, shumica është shprehur se nuk është respektuar, përfundim i cili është bazuar në analizën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, si kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit, sjellja e autoriteteve, si dhe rreziku që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih paragrafin 17 të vendimit*).

6. Qëndrimi i mësipërm i mbajtur nga shumica mendoj se nuk përmbush kërkesat për ta konsideruar vendimin në fjalë si mjet efektiv, i cili ofron mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur nga ana e kërkuesit. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, *mjetet* në dispozicion të një ndërgjyqësi *për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit* janë "efektive", në qoftë se ato *"parandalojnë shkeljen e pretenduar, pengojnë vazhdimin e saj ose ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur"*. Siç shprehet GJEDNJ-ja, neni 13 i KEDNJ-së ofron një alternativë: një mjet është "efektiv" në qoftë se mund të përdoret për të përshpejtuar dhënien e një vendimi nga gjykatat që gjykojnë një çështje ose për t'i ofruar ndërgjyqësit një riparim të përshtatshëm për vonesat që tashmë kanë ndodhur. Megjithatë, thekson GJEDNJ-ja, zgjidhja më e mirë është padyshim, parandalimi. Kur një sistem gjyqësor ka mangësi për sa i përket kërkesës në nenin 6/1 të Konventës - për një afat të arsyeshëm - një mjet i dizenjuar për të përshpejtuar procesin, me qëllim parandalimin e bërjes së këtij procesi të tejzgjatur, është zgjidhja më efektive. Një mjet i tillë ofron një avantazh të pamohueshëm në krahasim me një mjet që ofron vetëm kompensim, përderisa ai parandalon, gjithashtu, shkeljet e mëpasshme për të njëjtat procese dhe jo thjesht riparon shkeljen *a posteriori*, siç bën një mjet kompensues. Disa shtete kanë zgjedhur kombinimin e dy lloj mjeteve, njëri i

dizenjuar për të përshpejtuar procesin dhe tjetri për të ofruar kompensim (*shih Scordino kundër Italisë, nr. 1, aplikimi nr. 36813/97, §§ 183 dhe, 186, i cituar në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 10508/02, §§ 75 e 76*).

7. Duke e analizuar qëndrimin e shumicës nën dritën e standardeve të mësipërme, rezulton se vendimi nuk i ofron kërkuesit asnjë mundësi të qartë apo të sigurt për rivendosjen e së drejtës së pretenduar si të cenuar, sepse në fakt nuk ekziston ndonjë e drejtë materiale/procedurale e cenuar. Nëse u referohemi pretendimeve të kërkuesit, ai nuk pretendon interpretim të gabuar të ligjit nga Kolegji Administrativ deri në atë masë sa të cenojë të drejtën materiale.

8. Në mënyrë që procedura e ankimit individual kushtetues të përbëjë zgjidhje efektive, në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ-së, ajo duhet të japë edhe dëmshpërblim efektiv për shkeljen. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, parë në këndvështrim krahasues me kuadrin ligjor të vendeve të tjera, duhet të jetë e pajisur me kompetencën për urdhërimin e pagimit të kompensimit dhe/ose urdhërimin e *restitutio in integrum* (*shembulli i Austrisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Sllovakisë*).

9. Vlerësimi që bën shumica ka krijuar pritshmëri të gabuara dhe aspak realiste për kërkuesin. Nëse shumica do të kishte vlerësuar të kundërtën, pra bazueshmërinë e pretendimeve për cenimin e garancive të tjera procedurale gjatë procesit gjyqësor, atëherë kërkuesit do t'i jepej mundësia për të zhvilluar një proces gjyqësor të rregullt. Në këtë kuptim, edhe vlerësimi mbi kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit, edhe pse i natyrës thelbësisht deklarative, do të përbënte një mundësi dëmshpërblimi të drejtë për kërkuesin, edhe pse jo i natyrës materiale.

10. Shumica ka arsyetuar se ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih § 26 të vendimit*).

11. Qëndrimi i mësipërm i shumicës përbën një kthesë të menjëhershme të jurisprudencës kushtetuese në lidhje me vlerësimin e ndikimit që ka "*ngarkesa e Gjykatës së Lartë*" në respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të gjykimit të çështjeve brenda afateve të arsyeshme. Madje mendoj se është një vlerësim i nxituar dhe i shkëputur tërësisht nga realiteti kompleks. Ky vlerësim nuk nënkupton që sistemi ligjor vendas nuk duhet të jenë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, përkundrazi kjo është një domosdoshmëri jetike.

12. Misioni i Gjykatës Kushtetuese, krahas sigurimit të njëtrajtshmërisë të jurisprudencës kushtetuese për sa i takon vlerësimit të faktorëve që (nuk) garantojnë standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është edhe konstitucionalizmi i gjyqësorit të zakonshëm dhe nxitja e dialogut me të, në kuptimin që përmes vendimeve të saj Gjykata Kushtetuese e orienton atë drejt zhvillimit të proceseve gjyqësore që ofrojnë garanci procedurale dhe materiale për palët ndërgjyqësore. Madje për të shkuar edhe më tej, Gjykata Kushtetuese mund të orientojë edhe politikat ligjvënëse përmes jurisprudencës së saj.

13. Nëse shumica me vendimin në fjalë ka pasur parasysh edhe përmbushjen e këtyre objektivave në çështjen konkrete, mendoj se nuk ka mundur t'i përmbushë ato me sukses dhe me efektivitet. Para së gjithash Gjykata Kushtetuese duhet të jetë një mjet efektiv për garantimin e të drejtave dhe lirive që pretendohen se janë shkelur. Nisur nga ky vlerësim mendoj se në kushtet e mungesës të ndonjë të drejte procedurale dhe/ose materiale të cenuar gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, qëndrimi i shumicës për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i gabuar.

14. Në përfundim mendoj se shumica duhej ta rrëzonte edhe këtë pretendim të kërkuesit dhe të mos e pranonte pjesërisht kërkesën, për sa kohë konstatimi i shkeljes së nenit 42 dhe 6/1 të Konventës efektivisht nuk sjell një rezultat konkret për kërkuesin.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 70, datë 17.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtari	“	“
Sokol Berberi	anëtari	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtari	“	“
Besnik Imeraj	anëtari	“	“
Fatos Lulo	anëtari	“	“
Gani Dizdari	anëtari	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 2.7.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 36 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Gentian Doda

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014 dhe nr. 00-2014-1772 (188), datë 1.10.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si edhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 21, datë 26.1.2001, ka vendosur:

“Deklarimin fajtor të të pandehurit Gentian Doda për veprën penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal dhe e dënon atë me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Gentian Doda për kryerjen e veprës penale “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe e dënon me 1 (një) vit burgim. Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55/1 të Kodit Penal, e dënon të pandehurin Gentian Doda përfundimisht me 20 vjet burgim.”.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 317, datë 29.6.2001, ka vendosur: *“Mospranimin e ankimit ndaj vendimit penal nr. 41, datë 26.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.”.*

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 38, datë 6.2.2002, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 21, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.”.*

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 471, datë 26.7.2002, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Gentian Doda.”.*

5. Pas ekstradimit të tij në Shqipëri kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimeve të dhëna në mungesë të tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 03/60, datë 29.4.2013, ka vendosur: *“Të pranojë kërkesën e të gjykuarit Gentian Doda për të bërë rekurs kundër vendimit nr. 38, datë 26.2.2002 të Gjykatës Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 41, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.”.*

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari kundër vendimit nr. 38, datë 6.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë.”.*

7. Kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim të vendimit të formës së prerë nr. 21, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014, ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës për rishikim.”.*

II

9. ***Kërkuesi Gentian Doda*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

9.1 Është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t’u dëgjuar në procesin penal. Për arsye se është gjykuar në mungesë, kërkuesit iu pranua

kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur rekurs. Edhe pse Gjykatës së Lartë i lindte detyrimi të shqyrtonte nëse kërkuesi kishte marrë dijeni efektivisht për procesin, ajo vendosi mospranimin e rekursit, duke i cenuar atij përfundimisht të drejtën për t'u dëgjuar dhe për qenë i pranishëm në procesin e zhvilluar ndaj tij.

9.2 Është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se ajo nuk pranoi kërkesën për rishikim dhe nuk u dha përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesi për ekzistencën e një garancie të dhënë nga Ministria e Drejtësisë për rihapjen e procedimit penal.

9.3 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi katër gjyqtarë të Gjykatës së Lartë kanë qenë pjesë si e Kolegjit Penal, që ka shqyrtuar rekursin, ashtu edhe e atij që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim.

9.4 Është cenuar parimi i vendimit të arsyetuar, pasi Kolegji Penal nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për mospranimin e kërkesës për rishikim dhe rekurs.

10. ***Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, prapëson sa vijon:

10.1 Pretendimet në lidhje me vendimin që ka shqyrtuar rekursin janë haptazi të pabazuara. Gjykata e Lartë ishte investuar njëherë për shqyrtimin e rekursit, pasi mbrojtësi i kërkuesit kishte ushtruar rekurs në emrin e tij. Në këto kushte, Kolegji Penal nuk mund ta merrte përsëri në shqyrtim atë.

10.2 Të pabazuara janë edhe pretendimet që lidhen me vendimin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim. Kjo kërkesë është bazuar në garancinë e dhënë nga Ministria e Drejtësisë për rigjykimin e çështjes, por përfitimi i kësaj garancie lidhet edhe me respektimin e një afati 30-ditor në paraqitjen e kërkesës, i cili nuk është respektuar.

10.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, bazuar në praktikën e vendosur nga Gjykata Kushtetuese, gjykimi i kërkesës për rishikim nga disa prej gjyqtarëve që kishin shqyrtuar më parë edhe rekursin, nuk përbën shkelje të këtij parimi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimet për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit

12. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur pas rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, i ka cenuar atij të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Sipas tij, Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit duhej të verifikonte nëse kërkuesi kishte marrë dijeni efektivisht për procesin, në mënyrë që t'i jepte atij mundësinë e rigjykimit të çështjes. Po ashtu, ai ka pretenduar edhe cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal nuk ka dhënë arsyet për të cilat ka vendosur mospranimin e rekursit.

13. Gjykata vëren se neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse neni 433 se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar që në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë

të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 26, datë 9.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to, në rastin konkret, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së.

16. Edhe për sa i përket arsyetimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më sipër, vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se ky proces nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Për pasojë, pretendimet e kërkuesit në lidhje me këtë proces janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimet për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim

1. Për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim

18. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për arsye se në Kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim kanë marrë pjesë katër gjyqtarë, të cilët kishin marrë pjesë më parë në Kolegjin që ka shqyrtuar rekursin e paraqitur prej ai.

19. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës ka evidentuar se ky parim duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar "gjykatë e njëanshme" trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është

krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e çështjes së tij (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i parimit të paanshmërisë verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, si edhe testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata konstaton se bazuar në aktet e administruara rezulton se gjyqtarët E.I., SH.S., T.N. dhe A.Z., kanë marrë pjesë në Kolegjin Penal, i cili me vendimin nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014 ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë nr. 21, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Po këta gjyqtarë kanë marrë pjesë edhe në gjykimin në Kolegjin Penal, i cili me vendimin nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Gjykata ka vlerësuar se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy gjykime të iniciuara nga kërkuesi nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë çështje të ndryshme në të njëjtën gjykatë dhe me të njëjtët gjyqtarë, por i ndryshëm është qëndrimi kur i njëjti gjyqtar ose gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore (*shih vendimin nr. 7, datë 7.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se ai nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Ndërsa për sa i përket rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, vlerësimi që bën Kolegji i Gjykatës së Lartë në këto raste është i ndryshëm nga ai që bën kur vihet në lëvizje nëpërmjet rekursit. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Për këto arsye, rishikimi i vendimit, si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj. Natyra e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësimin e tyre (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret rezulton se kërkuesi pas ekstradimit në Shqipëri i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, e cila është pranuar. Për rrjedhojë, ai ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se nuk ka pasur dijeni për procesin, për shkak të mosnjoftimit në mënyrën e duhur nga autoritetet. Pasi ka marrë në shqyrtim rekursin, Kolegji Penal, me vendimin nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Po ashtu, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë edhe me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, bazuar në nenin 51/4 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" dhe nenet 450/c, 451-453 të KPP-së. Kërkuesi ka pretenduar se ekziston një garanci e dhënë nga shteti shqiptar për rigjykimin e çështjes penale ndaj tij në kushtet kur ai është gjykuar në mungesë. Në vendimin nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se "*të dënuarit të ekstraduar Gentian Doda i është përmbushur garancia e dhënë nga shteti shqiptar për rishqyrtimin e procesit të tij, mbasi pretendimet e tij janë*

shqyrtuar në rekursin e paraqitur prej tij në Gjykatën e Lartë" (paragrafi 18 i vendimit).

25. Edhe pse vlerësimet që gjyqtarët E.I., SH.S., T.N. dhe A.Z. kanë bërë gjatë shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi formalisht janë të ndryshme nga ato të bëra prej tyre gjatë shqyrtimit, po në dhomë këshillimi, të kërkesës për rishikim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dyja gjykimet, ato lidhen, në fakt, me shqyrtimin e së njëjtës çështje gjyqësore. Në këto, kushte pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto dy gjykime nuk ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm të kërkuesit në lidhje me paanshmërinë e gjykatës, aq më tepër kur këta gjyqtarë përbëjnë shumicën në numër të trupit gjykues. Kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenojë rregullsinë e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarëve E.I., SH.S., T.N. dhe A.Z. në trupin gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuesit se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm.

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, është i bazuar dhe duhet pranuar.

2. Për pretendimin për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

27. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se ajo nuk pranoi kërkesën për rishikim dhe nuk u dha përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesi për ekzistencën e një garancie të dhënë nga Ministria e Drejtësisë për rihapjen e procedimit penal. Po ashtu, ai ka pretenduar edhe cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për mospranimin e kërkesës për rishikim.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, edhe pretendimet e mësipërme të kërkuesit do të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme

detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë që e ka deklaruar atë fajtor dhe e ka dënuar në mungesë, duke pretenduar se ka pasur një shkresë nga Ministria e Drejtësisë lidhur me premtimin për rigjykim të tij, si kusht për ekstradimin e tij në Shqipëri. Edhe pse kërkuesi ka kërkuar nga Kolegjit Penal që ta kërkojë zyrtarisht këtë shkresë, me pretendimin se atij nuk i është vënë në dispozicion nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, kjo kërkesë nuk i është pranuar. Kolegji Penal në vendimin nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014 ka konstatuar se *"...kërkuesi Gentian Doda ka paraqitur në Gjykatën e Lartë rekurs kundër vendimit nr. 38, datë 26.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kjo dosje rezulton e regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 17.6.2013. Pa ezauruar mjetin e zakonshëm ankimor, në datën 10.9.2013 ka regjistruar në Gjykatën e Lartë kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 41, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Kolegji Penal, me vendimin nr. 00-2014-764, datë 15.5.2014, ka vendosur: mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari, kundër vendimit nr. 38, datë 6.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 433 të KPP-së, duke mos i gjetur të bazuara pretendimet e tij në lidhje me procesin penal të zhvilluar kundër tij. Në këto kushte, të dënuarit të ekstraduar Gentian Doda i është përmbushur garancia e dhënë nga shteti shqiptar për rishqyrtimin e procesit të tij, pasi pretendimet e tij janë shqyrtuar në rekursin e paraqitur prej tij në Gjykatën e Lartë. I dënuari është hetuar dhe gjykuar në mungesë, si rrjedhojë për të kërkuar të drejtën e tij për rigjykim ai ka pasur mundësinë të përdorë dy instrumente ligjore: i) rivendosjen në afat, për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin, i cili është mjeti juridik që ka vënë realisht në lëvizje gjykatën pas ekstradimit të tij... dhe ii) rishikimin... Në nenin 450 të KPP-së[3] janë parashikuar ndërkohë në mënyrë ezauruese rastet kur një vendim gjyqësor penal i formës së prerë mund të rishikohet nga autoriteti gjyqësor shqiptar. Konstatohet se në kërkesën për rishikim të paraqitur nga ana e kërkuesit Gentian Doda nuk paraqitet asnjë nga rastet e parashikuara nga katër shkronjat e nenit 450, por ai i referohet posaçërisht garancisë së dhënë nga ana e ministrit të Drejtësisë për rigjykimin e çështjes, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes, kërkesë të cilën e ka paraqitur edhe me rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs kundër vendimit nr. 38, datë 6.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë."*.

32. Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit procedural është atribut i gjykatave të sistemit gjyqësor dhe i organeve që e zbatojnë atë. Nisur nga ky parim, edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të kodeve të Procedurës dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Megjithatë, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej kësaj Gjykate, por vetëm nëse përmes këtij procesi cenohet e drejta kushtetuese themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në lidhje me kërkesën për rishikim, duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, ligjvënësi ka parashikuar se ajo mund të paraqitet vetëm për shkaqe specifikisht të përcaktuara në ligj dhe brenda disa afateve ligjore, të ndryshme nga ato që zbatohen për mjetet e zakonshme të ankimit. Kjo sepse ushtrimi i këtij mjeti ankimi lidhet me shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, të cilat mund të zbulohen rishtas nga palët dhe që janë të tilla që mund të riçelin një

[3] 1. Rishikimi mund të kërkohet:

a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;

c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë tregojnë se vendimi është i gabuar;

ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

gjykim të mbyllur në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Kërkuesi në kërkesën për rishikim drejtuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka pretenduar ekzistencën e shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, me anë të cilës garantohej rigjykimi i tij pas ekstradimit në Shqipëri. Po ashtu, ai ka pretenduar se ka qenë në pamundësi për ta paraqitur vetë këtë provë, për shkak se i është refuzuar kërkesa nga autoriteti kompetent (Ministria e Drejtësisë). Pavarësisht këtyre pretendimeve, Kolegji Penal nuk ka bërë asnjë përpjekje për të vërtetuar nëse kjo shkresë ekziston, në kushtet kur marrëveshja e ekstradimit mbështetej kryesisht mbi këtë fakt. Kolegji Penal ka arsyetuar në vendimin e tij, në thelb, se nëpërmjet pranimit të kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur rekurs dhe shqyrtimit të tij është përmbushur garancia e dhënë nga shteti shqiptar për rishqyrtimin e procesit. Në kushtet kur jo vetëm shkaqet ku bazohet mjeti i zakonshëm i ankimit, në rastin konkret rekursi, por edhe vlerësimi që bën Kolegji Penal mbi to janë të ndryshme nga ato mbi të cilat bazohet kërkesa për rishikim, si edhe në kushtet kur pretendimi për ekzistencën e garancisë nuk rezulton të jetë marrë më parë në shqyrtim apo t'i jetë dhënë përgjigje nga Kolegji Penal që ka shqyrtuar rekursin, i takonte këtij Kolegji të hetonte në lidhje me pretendimin e kërkuesit për garancinë e dhënë nga shteti shqiptar dhe t'i jepte atij një përgjigje të arsyetuar në këtë drejtim. Ky Kolegj nuk mund të mjaftohej vetëm me referimin te KPP-ja për shkaqet e rishikimit, por duhej të zbatohej edhe te detyrimet e tjera që ekzistojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti është palë dhe te ligjet që janë miratuar në zbatim të tyre. Për më tepër, ky detyrim rrjedh edhe nga praktika e GJEDNJ-së lidhur me gjetjen e të gjitha mundësive për të mos gjykuar të pandehurin në mungesë ose nëse kjo nuk është e mundur, atëherë të paktën të shihen mundësitë e rihapjes së procesit. Pra, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej ta kishte marrë në shqyrtim marrëveshjen në fjalë, si dhe të kishte analizuar detyrimin e marrë përsipër nga Ministria e Drejtësisë bazuar në këtë marrëveshje, sipas të cilit do të mundësohej rihapja e procesit gjyqësor ndaj kërkuesit pas ekstradimit të tij në Shqipëri.

35. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në kërkesën për rishikim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar as kërkesat e një vendimi të arsyetuar.[4]

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë pjesërisht kundër: Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Gentian Doda jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2014-1772, datë 1.10.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë. Për pasojë do të paraqes në vijim, në mënyrë të përmbledhur, argumentet për qëndrimin tim në pakicë, i cili është në linjë edhe me qëndrimet e mia të mëparshme në çështje të së njëjtës natyrë.

[4] Votoi kundër këtij pretendimi: S. Berberi.

2. Parimi i paanshmërisë së gjyqtarit/gjykatës është një nga elementet kryesore të së drejtës për një proces të rregullt. Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme, ku paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi apo anësie, dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Për të arritur në përfundimin nëse ky pretendim është i bazuar, Gjykata ia nënshtron atë dy testeve, konkretisht *testit subjektiv*, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, si edhe *testit objektiv*, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Për sa i përket testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta, kurse për sa i përket atij objektiv, ai kërkon fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Lidhur me paanshmërinë objektive, në çështjen *Gjonboçari kundër Shqipërisë,* GJEDNJ-ja ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij, por ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që ai kryen gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel. Po ashtu, as shqyrtimi paraprak i një informacioni të disponueshëm nuk do të thotë se paragjykohet shqyrtimi përfundimtar i çështjes.

3. Kërkesa më e rëndësishme në lidhje me çdo lloj procesi është vetëm ajo e shmangies që i njëjti gjyqtar, në marrjen e vendimit, të duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik të ndjekur më parë. Kusht i nevojshëm për të vlerësuar një rast papajtueshmërie është ekzistenca e vlerësimeve që bien mbi vetë *res iudicanda*, pra gjyqtari të mos jetë i kushtëzuar nga vlerësime të mëparshme të shprehura mbi të njëjtën *res iudicanda*, si pasojë e veprimtarisë së zhvilluar më parë. Do të ishim para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në rast se do të rezultonte e kompromentuar paanshmëria e gjyqtarit, qoftë në rastin kur gjyqtari ka manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim, qoftë kur vlerësimi i themelit është shprehur në një procedim të ndryshëm, por në çdo rast efektet cenuese duhet të vërtetohen *in concreto.*

4. Në rastin konkret rezulton se për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në të dyja kolegjet e Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar rekursin dhe kërkesën për rishikim, pra bindjes së tyre të brendshme, nuk ka asnjë provë për ta vënë në dyshim atë. Kurse për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet të hetohen rrethanat konkrete të çështjes.

5. Nga vendimet e kundërshtuara rezulton se Gjykata e Lartë fillimisht ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore, për pasojë ka vendosur mospranimin e tij, dhe më pas ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim, duke u shprehur edhe mbi pretendimet e paraqitura në lidhje me garancinë e dhënë nga shteti shqiptar për rigjykimin e çështjes penale në ngarkim të tij. Ndërsa gjykimi i parë është fokusuar mbi çështje të ligjit, vlerësimi i dytë është bazuar mbi çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e nenit 450 të KPP-së, më konkretisht nëse ekzistonte ndonjë nga shkaqet e parashikuara në këtë dispozitë për pranimin e kërkesës për rishikim, pra për çështje që nuk janë bërë më parë objekt shqyrtimi nga gjykatat e faktit, vendimet e të cilave ka kontrolluar Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit. Nuk rezulton që në shqyrtimin dhe marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën për rishikim, gjyqtarët që kanë qenë më parë pjesë e Kolegjit Penal që ka shqyrtuar rekursin të kenë përshkuar të njëjtin itinerar logjik, të kenë dhënë mendim mbi të njëjtat çështje, apo të kenë kryer të njëjtat vlerësime të dhëna më parë prej tyre. Në këtë kuptim, vetëm fakti i pranisë së të njëjtëve gjyqtarë në të dyja kolegjet, nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se gjykata ka qenë e njëanshme.

6. Për pasojë, duke pasur parasysh sa më sipër, vlerësoj se nga pikëpamja e testit objektiv veprimet e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, që kanë marrë pjesë si në Kolegjin që ka shqyrtuar rekursin në dhomë këshillimi, ashtu edhe në Kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim po në dhomë këshillimi, nuk janë të tilla që të vënë në dyshim standardin e paanshmërisë në gjykim, ndaj ky pretendim i kërkuesit duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata si i pabazuar.

7. Po ashtu nuk jam dakord edhe me qëndrimin e shumicës se Gjykata e Lartë në shqyrtimin e kërkesës për rishikim duhej t`i jepte përgjigje pretendimit të kërkuesit në lidhje me garancinë e dhënë, sipas tij, nga shteti shqiptar për rigjykimin e çështjes penale. Interpretimi dhe zbatimi i legjislacionit penal dhe në veçanti vlerësimi i ekzistencës ose jo të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit të formës së prerë është në kompetencë të Gjykatës së Lartë. Bazuar në nenin 450 të KPP-së, i cili parashikon shkaqet për të cilat mund të kërkohet rishikimi i vendimit të formës së prerë, dhënia e garancisë nga ana e shtetit shqiptar për rigjykimin e çështjes nuk parashikohet si i tillë. Megjithatë, duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe pavarësisht faktit se kërkuesi nuk ka arritur të provonte ekzistencën e një garancie të tillë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka marrë në shqyrtim këto pretendime dhe u ka dhënë përgjigje të arsyetuar, duke argumentuar se kjo garanci është përmbushur për sa kohë pretendimet e kërkuesit janë shqyrtuar nga Kolegji që ka marrë në shqyrtim rekursin, çka ka reflektuar mundësinë e respektimit të së drejtës për rigjykim në kuptim të garancive që jepen nga shteti shqiptar sipas ligjit për ratifikimin e Konventës për Ekstradimin. Në shqyrtimin e kërkesës për rishikim Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të kërkuesit.

8. Për sa më sipër, vlerësoj se në rastin konkret pretendimet e paraqitura nga kërkuesi Gentian Doda janë haptazi të pabazuara dhe Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

KËRKESË
Nr. 4865/4, datë 13.11.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës nga Muzeu Historik - Spitali, Vlorë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi "Saktësim dokumentacioni", do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 18,146,972 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani

Lista e objekteve që preken nga projekti: "Sistemim asfaltimi i rrugës nga Muzeu Historik - Spitali Vlorë"

Nr	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Adresa	Pronari	Siperfaqe Trualli	Siperfaqe ndertimi	Çmimi i Truallit Leke/m2	Çmimi i Ndertimit Leke/m2	Vlera e Truallit Leke	Vlera e Ndertimit Leke	Vlera truall dhe ndertese	Shenime sipas ZVRPP dhe dok. Te dorezuar
1	8601	7/200	Vlore	Kozma Tata	114	56	7,002	14,808	798,228	829,220	1,627,448	Certifikate pronesie
2	8601	7/159	Vlore	Ardian Dauti	0	66	7,002	14,808	0	878,287	878,287	Certifikate pronesie eshte mbajtur vlera e truallit per ndertimin jashte vijes se shpronesimit
3	8601	7/101	Vlore	Liri Shehu	27.98	0	7,002		195,916	0	195,916	Certifikate pronesie
4	8601	7//24	Vlore	Aranit Ibrahimaj		21	7,002	14,808	0	310,958	310,958	Vendim gjykate
5	8601	7//22	Vlore	Fitim Veizaj	0	20	7,002	14,808	0	296,160	296,160	Certifikate pronesie
6	8601	4//1	Vlore	B.P. Xhemali	53.03	100	7,002		371,316	? 5,734,457	6,105,773	Certifikate pronesie eshte mbajtur vlera e truallit per ndertimin jashte vijes se shpronesimit
7	8601	3//25	Vlore	Mahmut Balleshi	33.96	0	7,002		237,788	0	237,788	Certifikate pronesie
8	8601	3//86	Vlore	Mahmut Balleshi	42.7	0	7,002		298,985	0	298,985	Certifikate pronesie
9	8601	3//24	Vlore	Vilson Balleshi, Petrit Ba	7.18	109.2	7,002		50,274	0	50,274	saktesim dok.per truallin/P.P.V
10	8601	2//76	Vlore	Pellumb Ymeraj	16.17	107	7,002		113,222	5,886,312	5,999,534	sak. dokCertifikate pronesie
11	8601	2//75	Vlore	Enver Resuli	0	36	7,002	61,655	0	2,145,849	2,145,849	Vendim gjykate
											18,146,972	

V.o.: Çmimi i truallit është marrë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.7.2014.
Çmimi i ndërtesës sipas ZVRPP-së.
Çmimi i objektit të banimit sipas udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014.

KËRKESË
Nr. 1411/6, datë 13.11.2015
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia Fier. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të rikonstruksionit të bulevardit "Jakov Xoxa", në Bashkinë e Fierit është 9 375 880 (nëntë milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për realizimin i projektit rikonstruksioni i Bulevardit "Jakov Xoxa", në Bashkinë e Fierit

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kadastr.	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. në m²	Vlera e Përgjith. në lekë	Dokument pronësie
1	Ilirjana Ramaj	8532	5/1177	objekt	120		Vërtetim pronësie
2	Ilirjana Ramaj	8532	5/1177	truall	121	2 780 927	Vërtetim pronësie
3	Flamur Kafarani	8532	4/337	objekt	46		Vërtetim pronësie
4	Flamur Kafarani	8532	4/338	truall	46	1 983 197	Vërtetim pronësie
5	Arta Gjini	8532	4/594	objekt	24	478 500	Vërtetim pronësie
6	Zhaneta Furxhiu	8532	2/261-N2	objekt	9	179 439	Vërtetim pronësie
7	Luftar Agalliu	8532	2/261-N3	objekt	8.8	175 458	Vërtetim pronësie
8	Luftar Agalliu	8532	6/251	truall	27	805 155	Vërtetim pronësie
9	Arbër Bekaj	8532	6/249	objekt	27		Vërtetim pronësie
10	Arbër Bekaj	8533	6/249	truall	27	805 155	Vërtetim pronësie
11	Edmond Thanasi	8532	6/234	objekt	35		Vërtetim pronësie
12	Edmond Thanasi	8532	6/235	truall	35	1 409 261	Vërtetim pronësie
13	Aleksandër Zahoaliaj	8532	6/113-N1	truall	17.6		Vërtetim pronësie
14	Aleksandër Zahoaliaj	8533	6/113-N1	truall	17.6	758 788	Vërtetim pronësie
	Totali					9 375 880	

KËRKESË
Nr. 5275/4, datë 16.11.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të"Rrjetit të Kanalizimeve të Vlorës, faza 2, IPA 2012".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimit e Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik".

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e tokës "truall" është 198 570 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

Lista e pasurive që shpronësohen nga zbatimi i projektit "Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, faza 2, IPA 2012"

Nr	Stacioni pompimit	Nr.pas	zk	Indeksi hartes	pronaret	Lloji I pasurise	sip	Cmimi lek/m2
1	PS N4	45/23	8602	V1; AC-11	Irakli Cavo Evriniqi Stefa Vasilika Dushani Lefteri Gjyli	Toke truall	30m2	6 619 lek/m2
	Vlera totale							198 570 leke

KËRKESË
Nr. 5465/3, datë 16.11.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i Rrugës nr. 5, loti 2 dhe 3, Sarandë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Sarandë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 55, 638, 387 (pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN QE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "Ndertimi I Rruges te 5-te, Loti. II dhe III, Sarande ".

Nr	Pronari		Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Lloji i ndertimit	Siperfaqia		Çmimi		Vlera		Shenime
	Emri	Mbiemri				Truall m2	Ndertim m2	Truall lek	Ndertim lek	Truall lek	Ndertim lek	
1	RUSTEM	SHEHAJ	8642 L.3	11/168	Banese	309	398.2	10777	82395	3330093	29136719	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
2	LEVENT	ÇATO	8642 L.3	11/134	Banese	150.94	43	10777	situacion	1626680	324054	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
3	AGRON	KASO	8642 L.3	16/304	Banese	70	27.5	10777	82395	754390	2265863	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
4	GEZIM	ISUFI	8641 L.4	1/123	Truall	90	0	10777	0	969930	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
5	KOZMA	QURKU	8642 L.4	2/99,2/100,2/101	Truall	597	0	10777	0	6433869	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
6	MAZAR	ISUFI	8642 L.4	7/36	Truall	23.8	0	10777	0	256493	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
7	SHPETIM	CATO	8642 L.3	11.77	Truall	65	0	10777	0	700505	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
8	MERTIR	GJONI	8642 L.3	11/104	Truall	5	0	10777		53885	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
9	ANASTAS	PETKO	8641 L.3	19/141	Truall	52	0	10777	0	560404	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
10	RUZHDI	IBRAHIMI	8642 L.4	3/58	Banese+Truall	54	14	10777	82395	581958	1153530	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
11	JORGJI	MUKA	8642 L.4	5/197	Truall	335	0	10777	0	3610295	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
12	SHERIF	KASAJ	8641 L.4	3/87	Truall	110	0	10777	0	1185470	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
13	KOSTA	CILI	8642 L.3	8/178	Truall	5	0	10777	0	53885	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
14	HAXHEKO	PROI	8641 L.3	16/110	Truall	245	0	10777		2640365	0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
	Shuma					2111.74	482.7			22,758,222	32,880,166	
								VLERA TOTALE			55,638,387	Leke

Shënim: Çmimi për qytetin e Sarandes per banesat 82395 lekë/m² eshte marre nga ZVRPP Sarande dhe per truallin 10777 leke /m² sipas VKM

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë